



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 3 paragrafi 2, nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 10.04.2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **ZNJ. ELISA KARADŽI** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Prizren nga subjekti politik "Koalicija Vakati" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Memnuna Ajdini.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj. **Elisa Karadži** dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 01.04.2019, Nr.237/2019, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit komunal znj. Memnuna Ajdini, pas dorëheqjes së saj të përvokueshme nga pozita e anëtares të Kuvendit të Komunës, për arsye të zgjedhjes në pozitën e nënkryetares të Komunës.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirënditur, e cili është, znj. Elisa Karadži nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 10.04.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

